



VENDIM

Nr. 58 Datë 07.08.2009

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË
BALKAN GREEN ENERGY SH.P.K ME SERI PV03K, NR.3
LESHUAR ME VENDIM TE BORDIT TE KOMISIONEREVE TE
ERE-S NR.20, DT.19.12.2003**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Centralet Ekzistues me Kapacitet të Përgjithshëm jo më të madh se 5 MW” si dhe nenet 10 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr.21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.08.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.3, Seria PV03K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.20, datë 19.12.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit sic kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licensës me numër Nr.3, seri PV03K, lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionereve të ERE-s nr.20, dt.19.12.2003, të mbajtur nga shoqëria Balkan Green Energy sh.p.k
1. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Bujar Nepravishta
Kryetar i ERE-s
Ne mungese dhe me porosi
Z. Ardian Haçi